Nënkryetares

Nr. 717 Prot
09.03.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SHTETIT**
**DREJTORIA VENDORE E POLICISË VLORË**
**KOMISARIATI I POLICISË DELVINË**

*Adresa: Lagja "Sinan Ballaci" Delvinë-Shqipëri* *Telefon Faks +3558152417*

"i zakonshëm"

Nr. 207 .Prot. Delvinë më 06 .03.2020.

**Lënda: Kërkesë për bashkëpunim.**

**BASHKISË**
**DELVINË**

**Znj: KRYETARE E BASHKISË!**

**Në zbatim**, të Planit Kombëtar të Veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të bimës narkotike Cannabis Sattiva 2018-2020, VKM nr. 313, datë 31.05.2018, "Per një ndryshim në vendimin nr. 248, datë 29.03.2017" të Keshillit të Ministrave si dhe të Planit të Veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr 139 datë 27.01.2020 "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimeve narkotike për vitin 2020". Planit të Veprimit te Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë nr. 91 date 12.02.2020, "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike për vitin 2020". Urdhërit: Nr. 163, datë 08.02.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, "për ndarjen e zonave të përgjegjesisë të punonjësve të policisë, me qëllim kontrollin e territorit për identifikimin e autorëve dhe asgjesimin e bimëve narkotike, për vitin 2020".

**Duke vlerësuar**, se lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike Cannabis Sattiva, është prioritet i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Nisur nga fakti, se në ketë periudhë, fillon tendenca e kultivimit të bimëve narkotike.

**Me qëllim**, sensibilizimin e qytetarëve dhe kontrollin e plotë të territorit, në bashkëpunim me të gjitha agjenësitë e zbatimit të ligjit që kanë detyrime dhe përgjegjësi në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike në Rrethin e Delvinës,

**Kërkojmë**, rritjen e bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse të Bashkisë Delvinë, të Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, Zonave të Mbrojtura, Kryetarët e fshatrave, Shërbimin Zjarrfikës, me shërbimet e Komisartiatit të Policisë Delvinë, nëpërmjet fazës së parë sensibilizimin e qytetarëve dhe fazës së dytë atë operacionale, të shkëmbimit të informacionit dhe kontrollit të përbashkët të territorit që mbulon Bashkia, për identifikimin dhe asgjesimin e bimëve narkotike të kultivuara, dokumentimin e kësaj veprimtarie kriminale dhe vënien para përgjegjësise ligjore të autorëve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!

**Shefi i Komisariatit të Policisë**

**Komisar Dash... FRRAPAJ**